

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Nr. 02-41/02-07

Prishtinë, më 26 janar 2007, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 75 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 11 janarit 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Miratimi i tekstit përfundimtar të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastrën,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arbitrazhin,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e varieteteve të bimëve,
8. Debat për gjendjen e sigurisë në Kosovë,
9. Shqyrtimi i kërkesës së GP të AAK-së për miratimin e Rezolutës për organizimin e diasporës kosovare,
10. Shqyrtimi i kërkesës së grupit të deputetëve për të debatuar për tre qytetarë të Kosovës të akuzuar në Gjyqin e Hagës,
11. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar ORA për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm për rendin e ditës dhe për materialet e shpërndara për këtë seancë.

Miratimi i rendit të ditës

Për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Deputeti **Ferid Agani** kërkoi që seanca e sotme të marrë vendim lidhur me propozimin e të dërguarit të Sekretarit të OKB-së për statusin Kosovës, z. Mahtti Ahtisari, pas dorëzimit të pakos së tij Ekipit Negociator, propozimi t'u shpërndahet edhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Kryetari tha se kërkesa nuk është e natyrës së ngutshme. Ajo duhet të parashtrohet me shkrim në Zyrën për Propozime dhe Parashtrës.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se seanca e fundit, me rastin e miratimit të amendamenteve në Projektligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor, i kishte autorizuar Komisionin Funkcional dhe Shërbimin Ligjor të administratës së Kuvendit për t'i inkorporuar amendamentet e miratuara në Projektligj dhe tekstin përfundimtar t'ia paraqesin Kuvendit për miratim. Mirëpo, Komisioni dhe Shërbimi ligjor nuk e kanë spastruar dhe nuk e kanë lekturuar tekstin e Projektligjit, prandaj ai duhet të shtyhet për seancën e radhës, pasi teksti të spastrohet dhe të lekturohet.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së. Kuvendi me shumicë votash e miratoi këtë propozim.

Teutë Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s propozoi që në seancën e radhës të diskutohet për raportin e Auditorit Gjeneral për mënyrën e shfrytëzimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2005.

Fehmi Mujota, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, me qëllim të organizimit më të mirë, të dinamizimit dhe të funksionalizimit të Kuvendit, grupet parlamentare t'i paraqesin temat kryesore për tërë vitin vijues, që duhet të inkorporohen në kalendarin e punimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2007.

Kuvendi me shumicë votash **miratoi rendin e ditës**, të propozuar nga Kryesia e Kuvendit.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 11 janarit 2007

Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare të 11 janarit 2007.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, z Agim Çeku, lidhur me zhbllokimin e privatizimit të ndërmarrjeve dhe të objekteve shoqërore në komunën e Shtërpcës dhe në komunat e tjera të banuara nga komuniteti serb.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Bislimi**.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe të Mirëqenies Sociale lidhur me ndihmat sociale në shumën prej 40 € qytetarëve që i shfrytëzojnë pensionet nga vendet e Evropës Perëndimore.

Ministri **Ibrahim Selmanaj** iu përgjigj pyetjes së deputeti **Bislimi**.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtrroi pyetje ministrit të Drejtësisë lidhur me trajtimin e të burgosurve në Burgun e Dubravës.

Ministri **Januz Salihaj** iu përgjigj pyetjes së deputeti **Bislimi**.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtrroi pyetje ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë lidhur me akcizat për prodhuesit vendorë.

Zëvendësministri **Kadri Kryeziu** iu përgjigj pyetjes së deputeti **Bislimi**.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit lidhur me kushtet e vështira në disa objekte të shkollave në komunën e Vitisë.

Ministri **Agim Veliu** nuk ishte i pranishëm. Përgjigjja mbetet për seancën e radhës.

Deputeti **Genc Gorani** i parashtrroi pyetje ministrit të Pushtetit Lokal lidhur me kushtëzimet nga ana e administratës lokale dhe qendrore për t'u ofruar shërbime qytetarëve të vendit.

Ministri **Lutfi Haziri** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Gorani**.

Deputeti **Hajredin Hyseni** i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe të Mirëqenies Sociale lidhur me kushtet e banimit të disa qytetarëve të strehuar në Qendrën kolektive “Lagjja Kuvajtase” në Besianë.

Ministri **Ibrahim Selmanaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Hyseni**.

Deputeti **Bajrush Xhemajli** i parashtrroi pyetje ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë lidhur me mostransparencën e aneks kontratave ndërmjet AKM-së dhe të IMR-ALFERONIT.

Ministri **Bujar Dugolli** nuk ishte i pranishëm. Përgjigjja mbetet për seancën e radhës.

4. Miratimi i tekstit përfundimtar të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor

Me kërkesë të **Alush Gashit**, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, Kuvendi këtë pikë e shtyu për seancën e radhës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastrën

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----69;

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për kadastrën.

Pas kësaj kohe seancën e kryesoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arbitrazhin

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23 dhe 24.

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----69;

Kundër----- 1.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për arbitrazhin.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e varieteteve të bimëve

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----69;
Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi Ligjin për mbrojtjen e varieteteve të bimëve.

Kryesuesi dha pauzë për drekë.

8. Debat për gjendjen e sigurisë në Kosovë

Kryesuesi e ftoi propozuesin e kësaj teme ta marrë fjalën.

Jakup Krasniqi tha se Grupi Parlamentar i PDK-së në seancën e parafundit (21 dhjetor 2006), në bazë të rrethanave të sigurisë në vend, kishte kërkuar që Kuvendi të debatohet për çështjen e sigurisë në Kosovë. Patëm kërkuar nga ministri i Punëve të Brendshme të përgatitë një raport për gjendjen e sigurisë në vend, si material bazë për debat. Mirëpo, raporti, që e kemi marrë, nuk është i plotë, ofron më pak informacione sesa që kanë dhënë mjetet e informimit publik.

Në raport nuk janë përfshirë të gjitha segmentet që rrezikojnë jetën e qytetarëve të Kosovës. Nuk thuhet asgjë konkrete për aksionet e shumta shpërthyes, që kanë ndodhur gjatë këtyre viteve në Kosovë. Vepra të ndryshme kriminale nuk janë zbuluar.

Ministria është dashtë të sqaronte pse është bërë lëvizja e të burgosurve nga burgu i Mitrovicës Veriore? Pse një pjesë e administratorëve të asaj pjese tani i lëshojnë banesat e tyre dhe nuk është thënë se cila është shkalla e rrezikshmërisë që mund të vijë nga ajo pjesë?

Në raport thuhet se ekzistojnë strukturat e MUP-it dhe mekanizma të tjerë të Serbisë, që veprojnë në Kosovë, të cilat janë duke i monitoruar! Nuk dimë për çfarë monitorimi është fjala? Çfarë masash ka marrë Ministria ndaj tyre? Ministria është dashur të japë përgjigje konkrete. Ato mund ta rrezikojnë sigurinë në Kosovë. Nëse Ministria nuk ka pasur mundësi, atëherë është dashur të kërkojë ndihmë nga organet përgjegjëse për sigurinë në Kosovë.

Pastaj, **kryesuesi** e ftoi ministrin e Punëve të Brendshme ta paraqesë raportin për gjendjen e sigurisë në Kosovë.

Ministri **Fatmir Rexhepi** tha se me kërkesën e Kryesisë së Kuvendit ne kemi përgatitur një raport për të debatuar për gjendjen e sigurisë, për faktorët dhe masat, që duhet t'i marrim në përputhje me përgjegjësitë që i kemi.

Në vazhdim ministri Rexhepi paraqiti hollësi nga raporti për gjendjen e sigurisë në vend, të cilën e vlerësoi të qetë dhe stabile, përkundër rasteve të izoluara të prishjes së rendit dhe qetësisë publike, si dhe veprave kriminale.

Siguria e përgjithshme në Kosovë shoqërohet nga sfida dhe kërcënime të caktuara, të cilat përbëhen nga: procesi i përcaktimit të statusit të Kosovës; strukturat paralele; paraqitja e personave me maska; posedimi ilegal i armëve dhe vendosja e mjeteve eksplozive; mundësia e shprehjes së pakënaqësisë nga ana e qytetarëve, varësisht prej

rezultatit të statusit; gjendja e vështirë ekonomike dhe sociale e disa kategorive në shoqëri; krimi i organizuar; ekstremizmi fetar dhe transferimi i kompetencave.

Kosova gjendet në fazën e fundit të procesit të përcaktimit të statusit të saj. Në këtë kontekst propozimi i presidentit Martti Ahtisari mund të zgjojë pakënaqësitë e individëve apo disa grupeve të vogla në Kosovë.

Gjendja e sigurisë në pjesën Veriore të Kosovës vazhdon të mbetet çështja më e ndjeshme në vend gjatë procesit të statusit final

Në bazë të informacioneve që disponojmë, në Kosovë veprojnë organizata të ndryshme ilegale, si ato të MUP-it të Serbisë, që kryesisht funksionojnë nëpër vendbanimet e komunitetit serb. Mirëpo, këto struktura janë në monitorim të SHPK-së dhe Policisë së UNMIK-ut.

Njoftimet dhe raportet zyrtare të organeve të rendit dhe të sigurisë, po ashtu flasin se ka edhe organizata të ndryshme, si SHIK-u, SIA, si dhe grupe të tjera ekstremiste, të quajtura si AKSH.

Në bazë të raporteve nga SHPK-ja dhe të burimeve të hapura mund të arrihet në konkluzione gjysmake se në disa rajone në Kosovë, kryesisht në rajonin e Dukagjinit veprojnë grupe të maskuara, të cilësuara si kriminale dhe të armatosura, që grabisin qytetarët duke u prezantuar si pjesëtarë të të ashtuquajturës AKSH.

Gjatë muajve gusht-tetor 2006 janë evidencuar disa raste të izoluara, të shpërthimeve në rajonin e Gjilanit, në Klinë, në Dragash dhe në pjesën veriore të Mitrovicës, që kanë pasur një reflektim negativ në pasqyrën e sigurisë së përgjithshme në Kosovë.

Më 9 dhjetor 2006 në fshatin Shtuticë të komunës së Drenasit nga njësitë policore dhe të KFOR-it është zbuluar një sasi e madhe e armatimit të llojeve të ndryshme në një veturë kombi. Lidhur me këtë rast është bastisur edhe shtëpia e një të dyshuari tjetër, në oborrin e së cilës ishte parkuar kjo veturë, me ç'rast është gjetur një sasi e konsiderueshme e armatimit dhe e municionit. Rasti është klasifikuar nga SHPK-ja si "gjetje e armëve dhe e municionet - kontrabandim me armë dhe municion".

Më 3 janar 2007 rreth orës 01:20 në magjistralin Prishtinë-Mitrovicë, në afërsi të fshatit Babimoc, është qëlluar me armë zjarri polici i SHPK-së, Avni Kasumi nga komuna e Vushtrrisë. Rasti ka ndodhur derisa viktimja bashkë me dy kolegë të tij, ishte duke u kthyer nga detyra .

Për këtë rast janë marrë veprimet e domosdoshme, përfshirë këtu edhe konfiskimin e veturës dhe bastisjet e 17 shtëpive në fshatin me serbë Babimoc, ku është konfiskuar një sasi e konsiderueshme e armatimit dhe municionit.

Situata në Pejë prej përfundimit të luftës ka qenë e përcjellë me incidente të ndryshme. Megjithatë, vrasjet në stacionin policor në Pejë që kanë ndodhur gjatë vitit 2006, kanë zgjuar indinjatën e qytetarëve dhe kanë luhatur besimin e tyre në funksionimin e SHPK-së në Pejë. Për këtë arsye është ndërruar kreu i Komandës Regjionale të Pejës.

Bazuar në aktivitetet dhe në veprimet e shfaqura në formë protestash, duke përfshirë edhe veprimet e dhunshme, gjatë protestave të organizuara nga "Vetëvendosja", konsiderojmë se veprimet dhe format e tilla mund të paraqesin sfidë dhe provokim për rendin dhe qetësinë në Kosovë.

Gjendja e vështirësuar ekonomiko-sociale, sidomos te disa kategori të caktuara shoqërore, paraqet rrezik permanent për situatën e sigurisë.

Për dallim nga krimet e kategorive të përgjithshme, që kanë shënuar rënie, krimi i organizuar ka shënuar rritje, sidomos trafikimi i drogës, i qenieve njerëzore, prostitucion etj. Është themeluar një njësi e SHPK-së, që merret me luftimin e këtyre fenomeneve.

Në bazë të një raportit të SHPK-së lidhur me ekstremizmin islamik në Kosovë, del se lëvizja WAHABBI me ideologji ekstremiste islame në Kosovë ka filluar të përhapet menjëherë pas përfundimit të luftës.

Aktualisht vlerësohet se aktivitetet e pjesëtarëve të WAHABBI-t në Kosovë janë në fazën e krijimit të infrastrukturës së tyre.

Masat për ruajtjen e gjendjes së sigurisë

SHPK-ja ka hartuar një plan operativ të detajuar. Në kuadër të këtij plani Policia e UNMIK-ut ka rritur numrin e policëve në pjesën Veriore të Kosovës në 500, ndërsa SHPK-ja në 300.

Gjatë vitit 2006 janë trajnuar 1200 policë për përballimin e trazirave të mundshme. Ata janë të shpërndarë në të gjitha regjionet e Kosovës.

Sipas planit operativ është bërë shtimi i masave dhe i veprimeve në mbrojtjen e jetës dhe në sigurinë e personave dhe të pasurisë së tyre, me theks të veçantë në vendet ku jetojnë minoritetet.

Në fund, ministri **Rexhepi** theksoi se SHPK-ja, Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i kanë ngritur nivelin e masave të sigurisë në tërë territorin e Kosovës, në mënyrë që të ballafaqohen me të gjitha situatat eventuale, që mund të ndodhin në Kosovë.

Pas raportimit të ministrit të Punëve të Brendshme, Fatmir Rexhepi, **kryesuesi** e hapi debatin për shqyrtimin e gjendjes së sigurisë në vend.

Alush Gashi, në emër të Grupit parlamentar të LDK-së tha se e mbështesin raportin e ministrit dhe e inkurajojmë atë që t'ia paraqesin Kuvendit raporteve periodike për gjendjen e sigurisë në vend. Kërkojmë të shqyrtohet mundësia e shpërndarjes së buletineve ditore për gjendje të sigurisë për deputetë. Për ne siguria dhe stabiliteti janë parakusht për zhvillimin e institucioneve demokratike, andaj është domosdoshme funksionimi dhe kosovarizimi i organeve të zbulimit dhe të kundërzbulimit për parandalimin e veprimeve joligjore në Kosovë.

Zhvillimi i këtij sektori do të ndikonte në parandalimin e aktiviteteve të trafikimit dhe të krimit të organizuar, qoftë si transit apo ndonjë aktivitet vendor.

Naim Maloku në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së e mbështeti raportin e ministrit të Punëve të Brendshme për gjendjen e sigurisë në vend, si dhe hapat që i ka ndërmarrë kjo ministri në ngritjen e infrastrukturës organizative të saj.

Me interesim të shtuar përcjellim zhvillimet pozitive në fqinjësi, Maqedoni dhe në Shqipëri, sukseset që këto shtete i kanë arritur në luftën kundër krimit të organizuar atje. Mbështesim dhe e inkurajojmë Shërbimin Policor të Kosovës për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe të trafikimeve të paligjshme, si dhe për bashkëpunimin me policinë e vendeve të rajonit.

Mbajtja e paligjshme e armëve nuk është e nevojshme për qytetarët e Kosovës. Rendin e sigurinë duhet t'i mbajnë organet përgjegjëse për rend dhe siguri në Kosovë, të cilat duhet t'i mbështesim dhe t'i inkurajojmë për punën e tyre.

Ftojmë qytetarët e Kosovës të bashkëpunojnë me organet e rendit dhe të drejtësisë për zbardhjen e krimeve të kryera, si dhe për parandalimin dhe pengimin e krimeve të mundshme.

Ylber Hysa në emër të Grupit Parlamentar të ORA- tha se raportimi i ministrit të Punëve të Brendshme për gjendjen e sigurisë në vend është shumë i rëndësishëm dhe paraqet një kulturë të re politike, të cilën duhet ta vendosim në kuadër të mbikëqyrjes parlamentare mbi punën e ekzekutivit.

Në raport është dashur të përfshihen edhe të dhënat statistikore, që posedon kjo ministri, për ta ilustruar atë. Në pikën 2.7 rreth krimit të organizuar është dashur të ketë më shumë informata. Sa i përket pikës 2.8 për ekstremizmin islamik, ku realisht kjo ministri nuk ka shumë kompetenca, i ka dhënë vetes të drejtë të bëjë aso kualifikimesh, për të cilat është dashur të jetë shumë më e kujdesshme, sepse raporti është dokument zyrtar, të cilit mund t'i referohen edhe institucionet ndërkombëtare.

Një raport i tillë, para se të debatohet në seancë plenare, do të duhej të shqyrtohej në Komisionin për Siguri të Kuvendit, ku do të diskutohen edhe shumë aspekte të tjera, në mënyrë shumë më të hollësishme edhe rreth disa kualifikimeve për veprimin e institucioneve paralele, si dhe për veprimin e këtyre strukturave në Veri të Mitrovicës është dashur t'i kushtohet një rëndësi dhe ta bënin një lloj parashikimi për zhvillimet e mundshme.

Emin Krasniqi (PDK paraqiti disa vërejtje në raportin e ministrit të Punëve të Brendshme, ku në pikën 2.2 paragrafi 2 vlerësohet se ka organizata të ndryshme si SHIK-u, SIA dhe grupe të tjera ekstremiste. Për një vlerësim të tillë, në këtë raport, shtoi z. Krasniqi, tejet i pabazë, është dashur të konsultohet edhe kryeministri i Kosovës, z. Agim Çeku, se a pajtohet me këtë kualifikim. Në pikën 2.4, ku flitet për shpërthimet në Gjilan e gjetiu, është dashur të jepen shpjegime se a kanë qenë ato shpërthime të drejtuara për destabilizimin e vendit dhe për të kërcënuar jetën e qytetarëve, apo për interesa klanore.

Në pikën 2.8, ku jepen vlerësime për ekstremizmin islamik, përkatësish për lëvizjen WAHABIN jepet një kualifikim shumë i rëndë pa e kuptuar doktrinën dhe filozofinë e kësaj lëvizje.

Për të pasur një stabilitet dhe siguri të qëndrueshme duhet të miratohet Ligji për siguri në Kosovë, në bazë të cilit do të vepronin organet përkatëse të fushës së sigurisë.

Emrash Xhemajli (LPK) tha se e përgëzon ministrin e Punëve të Brendshme për paraqitjen e raportit për gjendjen e sigurisë në vend.

Unë, si përfaqësues i një subjekti opozitar, shtoi z. Xhemajli, kam një qasje pak më ndryshe nga pozita dhe subjektet e tjera të opozitës.

Ju, z. ministër, edhe më parë keni thënë se strukturat paralele të sigurisë, të dirigjuara nga Serbia, i keni në vëzhgim dhe monitorim. Por, dihet se monitorues është OSBE-ja, kurse Ju jeni degë e ekzekutivit.

Pse nuk flisni konkretisht për forcat ushtarake, policore dhe vullnetare serbe, që veprojnë në Kosovë?

Pse cekni vetëm emra të organizatave të sigurisë vendore, por nuk i cekni fare me emër organizatat ushtarake, policore dhe vullnetare serbe, që veprojnë në territorin e Kosovës, besoj se e dini edhe Ju, ngase thatë se jeni duke i monitoruar.

A paraqesin rrezik për sigurinë e Kosovës ato organizata z. ministër?

Në raport flitet për ekstremizmin fetar, që nuk është i plotë. Nuk ka të dhëna konkrete, por janë konstatime të përgjithësuara. E dyta, në raport nuk është përfshirë fare aktiviteti i ekstremizmit fetar ortodoks. Kisha Ortodokse Serbe gjithë veprimtarinë e saj e ka fokusuar në aktivitetin politik në dobi të shtetit të Serbisë dhe kundër Kosovës.

Nuk pajtohem me atë që thuhet në faqen 7 të raportit se shprehja e pakënaqësisë së qytetarëve përmes protestave demokratike mund ta provokojë sigurinë në Kosovë. Përkundrazi, çdokund në botë protestat konsiderohen ventile që i shërbejnë sigurisë.

Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar 6 plus tha se mbështet raportin e ministrit të Punëve të brendshme për sigurinë në Kosovë, por pati vërejte në pjesë e tij, ku flitet për ekstremizmin islamik. Në Kosovë, shtoi z. Murati, në mesin e besimtarëve të fesë myslimane nuk ka ndonjë aktivitet, që mund të jetë shkak për destabilizimin e situatës së sigurisë.

Lëvizja WEHABI, që përmend në raport, nuk ndonjë shtrirje të madhe në Kosovë dhe nuk ushtron ndonjë aktivitet që mund të vlerësohet se paraqet rrezik për çështje të sigurisë në vend.

Shërbimi Policor i Kosovës, sipas të gjitha anketave të qytetarëve të Kosovës, gëzon besimin më të madh të qytetarëve, punën e të cilit duhet mbështetur dhe të investohet në zhvillimin dhe pajisjen me teknikë adekuate për nevojat specifike të tij.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për gjendjen e sigurisë në Kosovë dhanë edhe këta deputetë: **Ramë Buja, Sokol Bashota, Xhevat Bislimi, Sabit Rrahmani, Fetah Berisha, Mark Krasniqi, Myrvete Dreshaj-Baliu, Xhelal Canziba, Gjylnaze Sylaj, Ragip Zekolli, Hydajet Hyseni, Zylfije Hundozi, Behxhet Brajshori, Nekibe Kelmendi, Gjergj Dedaj dhe Qibrije Hoxha**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Pas këtyre diskutimeve ministri, **Fatmir Rexhepi**, iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve.

Kryeministri i Kosovës, z. **Agim Çeku**, i falënderoi deputetët e Kuvendit për kontributin e dhënë gjatë debatit për çështjet e sigurisë në vend, të cilin ai e vlerësoi shumë konstruktiv dhe të dobishëm.

Në vazhdim kryeministri foli për përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për ngritjen e të gjithë mekanizmave të sektorit të sigurisë në vend.

Në fund të debatit, kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, **Jakup Krasniqi**, – parashtues i mocionit për debat, – e falënderoi Kuvendin që e ka shtruar mocionin për debat, ministrin për përgatitjen e raportit, si dhe të gjithë deputetët që morën pjesë në debat dhe dhanë kontribut për ta plotësuar raportin e MPB.

9. Shqyrtimi i kërkesës së GP të AAK-së për miratimin e Rezolutës për organizimin e diasporës kosovare

Me kërkesë të kryetarit të Kuvendit, z. Kolë Berisha, kjo pikë u shty për seancën e radhës.

10. Shqyrtimi i kërkesës së grupit të deputetëve për të debatuar për tre qytetarë të Kosovës, të akuzua në Gjykatën e Hagës

Me kërkesë të kryetarit të Kuvendit, z. Kolë Berisha, kjo pikë u shty për seancën e radhës.

11. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar ORA për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

Kuvendi, me propozim të Grupit Parlamentar ORA, me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

Deputeti **Genc Gorani** emërohet anëtar i Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, në vend të deputetit Ylber Hysa.

Deputeti **Ylber Hysa** emërohet anëtar i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në vend të deputetit Genc Gorani.

Kryesuesi seancën e sotme e deklaroi të mbyllur në orën 17:20 minuta

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale